


Nr.regj. 16952/2010



**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehures Fatmire Musliu nga Mitrovica, për kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 15.04.2011 merr këtë:

## AKTVE N D I M

**E PANDEHURA:** **Fatmire (Sahit) Musliu**, e lindur në vitin 1972 në Mitrovicë, tani me vendbanim të përkohshëm në Berlin të Gjermanisë, e punësuar si Sekretare e Parë në Ambasadë në Berlin, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike,

## Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepse, si Zyrtare e Lartë Publike në Ambasadën në Berlin të Gjermanisë, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, deri më datën 31.03.2011

- **me veprim të tillë ka kryer kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj të pandehures për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

## D Ë N I M I

**Me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro)**, të cilën shumë e pandehura është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave të KGJK-së No. 1000 4300 7000 0518. Paguesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga gjykata. Një kopje e fletëpagesës të kthehet në gjykatë. Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar komfor nenit 5 të LK, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditë, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgu.

Komfor nenit 109 të LK, në emër të paushallit gjyqësor, e pandehura është e obliguar të paguaj shumën prej 10 Euro në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'u dorëzohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehures.

## A r s y t i m

**Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë**, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën 01/2280/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehures të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë e njëjta në Agjencinë kundër Korrupsion nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars 2010.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehuren e cila në mbrojtjen e saj deklaroi se nuk e ka dorëzuar formularin për deklarin të pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion vetëm për shkak të obligimeve të saja të punës dhe atyre familjare për çka më pastaj është njoftuar se ndaj saj është ngritur procedura kundërvajtëse.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehures dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi ekzistimin e veprës kundërvajtëse, meqë e njëjta është dashur që me marrjen e pozitës që aktualisht ajo mbanë, është dashur të jetë më e vëmendshme dhe të jep

prioritet përmbushjes së obligimeve ligjore për dhe lidhur me pozitën e saj, andaj gjyqtarja e shpalli përgjegjës për këtë kundërvajtje dhe e dënoi me gjobën e paraparë ligjore.


Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarës së lartë publike si dhe personalitetin e saj, të njëjtës ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se e pandehura në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj.16952/2010, datë 15.04.2011

Gjyqtarja  
Suzana Cerikini

**KESHILLA JURIDIKE:** Kërkesë për këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimi të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksë.